



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

Adresa: Rruga e Kavajës, Nr. 1001
Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Kati II, Tiranë
Website: www.amshc.gov.al E-mail: info@amshc.gov.al

20.10.2014

PËRDITËSIM NGA AMSHC NR. 2

12 - 15 qershor 2014

Pragë, Republika Çeke

Takim përgatitor organizuar nga “The European Grassroots Antiracist Movement (EGAM)”

"The European Grassroots Antiracist Movement" (EGAM) organizoi në Pragë, takimin përgatitor për eventin evropian “Krenaria Rome”.

Në kuadrin e konsolidimit të bashkëpunimit të AMSHC-së me partnerët ndërkombëtare, morën pjesë në këtë takim Kryetari i Bordit Mbikëqyrës i AMSHC-së z. Adrian Thano, anëtari i Bordit z. Aldo Merkoçi si dhe Drejtori Ekzekutiv i AMSHC-së z. Andi Kananaj.

Qëllimi i këtij takimi ishte që të përgatisë organizatat e komunitetit rom si dhe ato anti-raciste, nga e gjithë Evropa, për aktivitetin “Krenaria Rome”, që do të organizohet në vjeshtë, duke bërë bashkë liderët e këtyre organizatave nga 25 vende, për të koordinuar punën e tyre si dhe bashkëpunuar për përgatitjen e këtij aktiviteti.

Aktiviteti "Krenaria Rome" është një ngjarje vjetore mbarë evropiane. Ajo zhvillohet në të njëjtën kohë në 10 deri në 15 vende, dhe punohet për ta zgjeruar atë çdo vit. Aktiviteti "Krenaria Rome" është mobilizimi i shoqërisë për mbrojtjen e dinjitetit dhe të të drejtave të romëve. Ky aktivitet ka për qëllim të dënojë diskriminimin ndaj komunitetit rom, të promovojë barazinë si dhe të mbrojë kulturën rome.

Një nga pikat e forta të aktivitetit “Krenaria Rome” është se ky aktivitet do të organizohet nga koalicioni i krijuar midis organizatave të komunitetit rom me organizatat anti-raciste dhe mbrojtëse të të drejtave të njeriut.

18 qershor 2014

Prishtinë, Republika e Kosovës

Konferencë rajonale organizuar nga "Technical Assistance to Civil Society Organisations Project (TACSO)"

Drejtori Ekzekutiv i AMSHC-së z. Andi Kananaj dhe anëtari i Bordit Mbikëqyrës të AMSHC-së z. Ismail Ademi morën pjesë në konferencën rajonale "Përmirësimi i Kuadrit Ligjor dhe Institucional për Financimin Publik". Fokusi dhe synimi në këtë konferencë ishte kontribimi në përmirësimin e mekanizmave, aspekteve ligjore dhe procedurale të financimit publik në lidhje me mbështetjen financiare për organizatat e shoqërisë civile në Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë.

30 maj - 30 qershor 2014

Shpallja e Thirrjes Nr. 5 për projekt-propozime

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC), në kuadrin e konkurrimit të hapur dhe transparent sipas kriterëve të përcaktuara në Ligjin Nr. 10093, datë 09.03.2009, "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile", nga data 30 maj - 30 qershor 2014, hapi Thirrjen Nr.5 për projekt propozime, për OJF-të që operojnë në vendin tonë.

Kjo thirrje si fokus kryesor kishte fushat e mëposhtme:

1. Qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit (Lufta kundër korrupsionit, pandëshkueshmërisë etj);
2. Forcimi i institucionit të tolerancës dhe dialogut si vlera themelore të demokracisë (të drejtat e njeriut, lufta kundër dhunës dhe diskriminimit, diversiteti si vlerë dhe pasuri për një shoqëri demokratike);
3. Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm (turizmi, shëndeti publik, shkollat, etj);
4. Fuqizimi i kapaciteteve të brezit të ri nëpërmjet nismave të sipërmarrjes së lirë;
5. Promovimi dhe menaxhimi i vlerave të trashëgimisë kulturore;
6. Fuqizimi i bashkëpunimit dhe partneritetit midis organizatave të shoqërisë civile; forcimi i kapaciteteve të vetë organizatave; nxitja e përfshirjes së shoqërisë civile në politikë-bërje dhe në vendimmarrje;

Gjatë kësaj thirrje u vu re një shtim i numrit të aplikimeve të OJF-ve krahasuar me thirrjet e mëparshme. Sasia e aplikimeve të paraqitura pranë AMSHC-së arriti 245 aplikime, rreth 121 aplikime më shumë se në thirrjen e mëparshme, të cilat kishin një shtrirje gjeografike në mbarë vendin.

Faktorët që ndikuan pozitivisht në arritjen e këtij rezultati, kanë qenë lehtësimi i procedurave të aplikimit si dhe seancat orientuese të organizuara nga stafi i AMSHC-se ku një numër i madh organizatash të interesuara morën informacion lidhur me plotësimin e formularit të aplikimit si dhe dokumentacionit përcjellës. Numri i madh i aplikimeve është një indikator që tregon rritjen e besueshmërisë së shoqërisë civile në bashkëpunimin me AMSHC-në.

Pas shqyrtimit dhe vlerësimit të të gjitha aplikimeve të depozituara pranë AMSHC-së, Bordi Mbikëqyrës shpalli listën e projekteve fituese, për të cilat u vijua me lidhjen e kontratave.

11 gusht - 10 shtator 2014

Shpallja e Thirrjes Nr. 6 për projekt-propozime

Në vijim të punës dhe të përmbushjes së misionit të saj, Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, për të mbështetur organizatat jofitimprurëse në punën për realizimin e misionit të tyre, shpalli Thirrjen Nr. 6 për shpërndarjen e pjesës së mbetur të grantit dedikuar shoqërisë civile.

Fokusi kryesor i kësaj thirrje janë fushat e mëposhtme:

1. Rritja e ndikimit të shoqërisë civile dhe përfshirja në hartimin dhe në proceset e miratimit të politikave/reformave publike;
2. Qeverisja e mirë, forcimi i institucioneve, shoqërisë dhe i dialogut, fuqizimi i të rinjve nëpërmjet vlera themelore të demokracisë (pjesëmarrja, të drejtat e njeriut, shteti i së drejtës, kultura etj);
3. Mbrojtja e mjedisit, zhvillimi rajonal, ekonomik dhe zhvillimi i qëndrueshëm (trashëgimia kulturore, turizmi, shërbimet publike dhe inovacioni etj);
4. Rritja e ndikimit publik dhe veprimtarisë së organizatave të shoqërisë civile, rrjetëzimi dhe bashkëpunimi në kuadër të përafrimit me Bashkimin Evropian dhe bashkëpunimit/zhvillimit rajonal;
5. Krijimi e konsolidimi i aftësive të shoqërisë civile në komunikimin publik dhe edukimin qytetar, nxitja e qytetarëve në veprimtari, përfshirja e pjesëmarrja e tyre për zhvillimin e komunitetit.

Milano, 17 - 18 shtator 2014

Firmoset Memorandumi i Bashkëpunimit AMSHC – CELIM për Rajonin e Lombardisë



Në kuadër të forcimit të mardhënieve me jashtë të AMSHC-së, drejtori Andi Kananaj sëbashku me anëtarin e bordit që ndjek mardhëniet me Italinë, Ismail Ademi, kanë zhvilluar një vizitë dyditore në qytetin e Milano-s. Rajoni i Lombardisë, ku jetojnë më shumë se 100 mijë qytetarë shqiptarë, është nga më të avancuarit për sa i përket zhvillimeve të sektorit të tretë dhe shoqërisë civile.

Ftesa për këtë vizitë erdhi nga OJF-ja italiane CELIM, e cila prej më shumë se 50 vitesh është aktive në Itali dhe prej të paktën 10 vitesh ka aktivitete dhe projekte domethënëse si në Shqipëri ashtu dhe në Kosovë. Në kuadrin e konferencës përmbyllëse të projektit “Albania Domani”, të financuar nga Fondacioni Cariplo me 3 milionë euro, drejtori i AMSHC-së u ftua të mbante një fjalë rreth funksionimit të Agjencisë në mbështetjen e shoqërisë civile dhe lidhjet që kjo e fundit mund të aktivizojë për një rol më aktiv në projektet e bashkëpunimit për zhvillim dhe çështjeve të emigracionit.

Gjatë këtyre dy ditëve qëndrimi në Milano, përfaqësuesit e AMSHC-së patën takime specifike me disa prej aktorëve më të rëndësishëm të sektorit. Gjatë takimit me organizatën CELIM, u ra dakord dhe u firmos një Memorandum bashkëpunimi që parashikon një partneritet CELIM – AMSHC për projekte të përbashkëta, duke filluar që nga ky vit. CELIM do të jetë antena e AMSHC-së në rajonin e Lombardisë, duke bërë të mundur në këtë mënyrë aktivizimin e partneriteve institucionale dhe me aktorë të shoqërisë civile, në funksion të zhvillimit të ideve të përbashkëta dhe aktivitetit të fundraising.

Gjithashtu u ra dakort parimisht për të bërë të mundur praninë e AMSHC-së në seksionin për shoqërinë civile në EXPO 2015.



Një takim tjetër i frytshëm ishte edhe ai me zyrën për marrëdhëniet ndërkombëtare pranë Kryetarit të Bashkisë së Milano-s. Marco Grandi, drejtori i zyrës shprehu nevojën e kontakteve insitucionale me Shqipërinë për sa i përket sektorit të shoqërisë civile, dhe AMSHC-ja do të jetë kanali preferencial i Bashkisë së Milano-s për sa i përket projekteve të përbashkëta. Takime të tjera u zhvilluan me konsullatën shqiptare në Milano dhe me shumë shoqata shqiptare me seli në Lombardi, të cilat janë aktive në fushën sociale dhe të bashkëpunimit ndërkombëtar.

7, 8, 9 tetor 2014

Takime konsultative "Ndajmë vizionin e përbashkët për bashkëpunim strategjik"

Me synim fillimin dhe zhvillimin e një bashkëpunimit të frytshëm dhe të suksesshëm midis AMSHC-së dhe Shoqërisë Civile; AMSHC-ja organizoi takimet konsultative në datat 7, 8, 9 tetor 2014; respektivisht në Vlorë, Pogradec dhe Tiranë nën moton:

“Ndajmë vizionin e përbashkët për bashkëpunim strategjik”



Në kuadër të hartimit të Strategjisë Afatmesme dhe Afatgjatë në funksion të përmbushjes së misionit të saj, AMSHC-ja mblodhi informacione e opinione me aktorë dhe faktorë të ndryshëm që veprojnë në fushën e shoqërisë civile.



Duke besuar se fuqizimi i shoqërisë civile është një mjet i rëndësishëm në lidhjen mes qytetarëve dhe institucioneve, AMSHC-ja është e vendosur të jetë një nxitës aktiv për një klimë të shëndetshme për pavarësinë,

efektivitetin dhe qëndrueshmërinë e shoqërisë civile. Ky proces i gjerë konsultativ i realizuar me shoqërinë civile kishte qëllim, pikërisht iniciimin e nismave të reja ligjore, si dhe për monitorimin e vlerësimin e tyre. OJF-të e zonave respektive, sipas axhendës patën mundësinë të japin kontributin e tyre konkret për iniciimin e nismave të reja ligjore, si dhe për monitorimin e vlerësimin e tyre. Interesimi i OjF-ve për këto takime konsultative ishte i madh, duke patur një pjesëmarrje të gjerë me gati me shumë se 120 përfaqësues të OJF-ve.

Ky cikël takimesh konsultative i inicuar nga AMSHC-ja ishte i pari dhe do të vijojë me një cikël të dytë që do të mbulojë pjesën veriore të Shqipërisë.

Për të lehtësuar dhënien e opinione vetë tyre, ju është shpërndarë paraprakisht një pyetësor i shkurtër. Përgjigjet e tyre u përmbledhën dhe që u bënë pjesë e diskutimit në aktivitet, por



sigurisht do të jenë pjesë e axhendës së punës së AMSHC-së.

Pjesëmarrësit vlerësuan këtë iniciativë të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile is një instrument të rëndësishëm i dialogut midis shoqërisë civile dhe institucioneve.

Referuar problematikave kryesore të ngritura të evidentuara nga aktorët e shoqërisë civile gjatë takimeve, u identifikuan fushat ku do të fokusohet bashkëpunimi AMSHC – shoqëri civile:

A. Fuqizimi i rolit të AMSHC

1. Fuqizimi i pozitës lobuese të AMSHC-së, p.sh të ndikojë në heqjen e TVSH-së për OJF-të, pra të shikohet ligji për TVSH-në për OJF-të
2. Fuqizimi i rolit të Bordit Mbikëqyrës i AMSHC-së në drejtim të përfaqësimit dhe varësisë:
 - Duke rritur përfaqësimin në bord të anëtarëve nga shoqëria civile dhe reduktuar përfaqësimin e anëtarëve nga qeveria dhe institucionet shtetërore (duhet fuqizuar dhe duhet të ketë me pak anëtarë përfaqësues të qeverisë, të ketë më shumë anëtarë nga shoqëria civile, të ketë përfaqësues edhe nga kuvendi.
 - Duke reduktuar varesinë e Bordit nga Qeveria (duhet të jetë një strukturë jo e varur nga qeveria, por mbi qeverinë).

3. AMSHC-ja përballet me sfidën për përmirësimin e imazhit të saj. Të merret një iniciativë ligjore për vullnetarizmin si dhe rritja e kapaciteteve.
4. Rifreskimi i të dhënave të regjistrit aktual të OJF-ve, pasi një pjesë e madhe janë jo aktive. Të mbledhet informacion për të parë sa të punësuar ka ky sektor

B. Fuqizimi i kapaciteteve dhe rolit të shoqatave (shoqërisë civile)

1. Të rritet roli i AMSHC-së në rregullimin e kuadrit ligjor për profesionet e rregulluara.
2. Tarifat e shërbimeve bazë për organizatat jo-fitimprurëse, janë kosto për OJF-të. Të krijohen lehtësira.
3. Krijimi i lehtësirave nepermjet uljes së tarifave për shërbimet bazë që do të ndikojnë në uljen e kostove për OJF.
4. Rritja e kujdesit për shtresat Kujdes të vecantë për shtresat vulnerabël, shtresat në nevojë
5. Fuqizimi i shoqatave të sapokrijuara, rritja e kapaciteteve të tyre
6. AMSHC duhet të financojë projekte për të parë si zbatohet konflikti i interesit.
7. Riintegrimi i emigrateve shqiptarë që zgjedhin të jetojnë e punojnë në vendin e tyre. Promovimi i aktoreve të shoqërisë civile për orientimin e të rinjve drejt tregut të punës, pasi të rinjtë që janë të papunë dhe ndjehen pesimiste;
8. Edhe vetë Shoqëria Civile duhet të bashkëpunojë me administratën publike.
9. Duhet të ketë më shumë transparencë nga të gjithë aktorët e shoqërisë civile përfshirë dhe AMSHC-në.
10. Krijimi i një modeli të suksesshëm për vullnetarizmin.
11. Shoqëria Civile duhet të jetë nismëtarja e të gjitha nismave
12. Rritja e kapaciteteve e grupeve që kanë si mision të tyre shërbimet.
13. Duhet më shumë vëmendje ndaj personave me aftësi të kufizuar.
14. Të trajtohen dhe problemet të inovacionit.
15. Të bëhen trajnime me përfaqësuesit e OJF-ve për të orientuar më mirë sipas legjisllacionit evropian.
16. Përafrimi i legjisllacionit tonë me atë të BE në të gjitha fushat por kryesisht atë të shoqërisë civile.
17. Të ketë pjesëmarrje aktive të shoqërisë civile në komisionet parlamentare.
18. Të behet përpjekje për heqjen e tatimeve të ngarkuara pa të drejtë nga sistemi tatimor në kurriz të OJF-ve.
19. Të krijohen forume të përbashkëta rajonale (Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mal i Zi etj.) për tekstet shkollorë, arsimin etj.

Tiranë, 10 tetor 2014

Workshop i organizuar nga "Instituti për Kërkim dhe Zhvillim Barleti" në bashkëpunim me "Institutin Adriapol – Smart and Creative Development"



Drejtori Ekzekutiv i AMSHC-së, Z. Andi Kananaj mori pjesë në Workshop-in e organizuar nga Instituti për Kërkim dhe Zhvillim Barleti në bashkëpunim me "Institutin Adriapol – Smart and Creative Development", në kuadër të projektit "RiSi – Rini Sipërmarrëse", projekt ky i mbështetur me financimin e Angjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC), me temë: "Përshtatshmëria e Legjislacionit dhe faktori politik për të stimuluar Sipërmarrjet e reja, Start up dhe Spin Off".

Organizatorët vlerësuan dhe falenderuan AMSHC-në dhe Drejtorin Ekzekutiv të saj për mundësimin financiar për përmbushjen e realizimit të projektit me qëllim pikërisht krijimin e një gjenerate të rinjsh sipërmarrësish nëpërmjet fuqizimit të oportuniteteve të rrjeteve bashkëpunuese dhe suportit të dedikuar në fazat e konkretizimit të idesë sipërmarrëse.